



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prilazto Received/Delivety	17-01-2024	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KOMPJUTER	308/2024		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1483/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1438/2023 të datës 06.12.2023 të parashtruar nga ankuesi më adresë

kundër Vendimit me Nr.1976 të datës 17.11.2023 të Komisionit të Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1483/2023 e datës 06.12.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.1976 i datës 17.11.2023 i Komisionit të Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme më datë 14.07.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr. Reference: RN00012073 për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën Inspektor i Tregut', 27 pozita, në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ku afati për aplikim ka qenë nga data 04.08.2023 deri më datë 11.08.2023.

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, i cili ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke plotësuar kushtet e konkursit, ndërsa i është nënshtruar edhe fazës së testimit me shkrim dhe vlerësimin të jetëshkrimit, ku nga këto dy vlerësime gjegjësisht në testin me shkrim ka marr gjithsej 48 pikë, ndërsa nga vlerësimi i jetëshkrimit ka marr gjithsej 8.4 pikë, me çka nënkupton se nuk ka marr 60 pikë për t'iu nënshtruar fazës tjetër të vlerësimin konkretisht intervistës me gojë.

Pas përfundimit të procedurës më datë 07.11.2023 është publikuar njoftimi për renditjen përfundimtare të kandidatëve, ku në bazë të kësaj rezulton se vetëm shtatë (7) kandidatë kanë arritur që nga të gjitha fazat të marrin 70 pikë e më tepër, ndërsa ankuesi në këtë listë është renditur me gjithsej 53.4 pikë me numrin rendor 17, ndërsa ankuesi për këtë rezultat është njoftuar përmes emailit të datës 09.11.2023.

Ankuesi kundër rezultatit përfundimtar të vlerësimin më datë 11.11.2023 ka parashtruar ankesë tek Komisioni i Pranimit për Institucionet Shtetërore për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm për rishikim të vlerësimin të testit me shkrim dhe vlerësimin të jetëshkrimit. Komisioni i Pranimit për Institucionet Shtetërore për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm më datë 17.11.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 1976 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi njoftimin për rezultatin përfundimtar.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.1976 të datës 17.11.2023 të Komisionit të Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm, më datë 06.12.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7251/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli më datë 18.12.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 7251/2023 të datës 06.12.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Dokument identifikimi i ankuesit; Konkursin me Nr. Reference RN00012073 për Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Vendimin me Nr. port: 1320 i datës 25.08.2023; Njoftimin e datës 11.09.2023 dhe 19.09.2023; Vendimin me Nr. 02/164 të datës 09.10.2023; Vendimin me Nr. 1679/2023 i datës 10.10.2023; Emailin e datës 19.10.2023 nga S.K për ankuesin dhe anasjelltas; Njoftimin e datës 25.10.2023, 31.10.2023, 09.11.2023 nga SIMBNJ për ankuesin; Njoftimin e datës 09.11.2023 nga për ankuesin; Njoftimin e datës 09.11.2023; Ankesat e ankuesit të datës 11.11.2023; Vendimin me Nr. 1976 të datës 17.11.2023; Njoftimin e datës 20.11.2023; Konkursin me Nr. Reference RN00012518 për Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Njoftimin nga SIMBNJ për ankuesin i datës 01.12.2023; Emailin e datës

01.12.2023, 04.12.2023 nga për ankuesin; Konkursin me Nr. Reference RN00012515 për Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Njoftimin nga SIMBNJ për ankuesin i datës 05.12.2023; Plotësimin e ankesës datës 03.01.2024; Konkursin me Nr. Reference RN00011539 për Specialist i Posaçëm për Inspektim; Konkursin me Nr. Reference RN00011540 për Specialist i Posaçëm për Inspektim; Certifikatën mbi dënimet penale e datës 27.06.2023; Vendimin me Nr. 22/2023 i darës 27.06.2023; Vendimin me Nr. 2/2023 i datës 03.07.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 14.12.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 18.12.2023; Listën e aplikantëve; Emailin e datës 11.09.2023 nga për ankuesin; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 07.11.2023; Aplikacionin e ankuesit me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit me dokumentet e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar kundër Vendimit me Nr.1976 të datës 17.11.2023 të Komisionit të Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm, pretendon se në këtë procedurë dy herë është shtyrë afati njëherë në fazën e verifikimit paraprak dhe herën tjetër në fazën e testit me shkrim në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe ka kundërligjshmëri për shkak se afati edhe pse është shtyrë afati për 30 ditë testi me shkrim është mbajtur më datë 24.10.2023 ndërsa sipas shtyrjes i bie që testi me shkrim të mbahej prej datës 11.11.2023 e tutje; Vlerësimi i jetëshkrimit nuk është real ngase në dy konkurse për një grup të njëjtë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi jam vlerësuar në këtë fazë me 15.6 pikë gjegjësisht me 15.40 pikë; Kështu që Këshilli të shqyrtoj edhe kërkesat që kërkohen për Inspektor kur me Ligjin për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut për Inspektor kërkohet përgatitje superiore dhe tri vite përvojë punë në profesion; Vendimin për refuzim të ankesës e kam marr vetëm nga Komisioni i pranimit ndërsa nuk kam marr ende përgjigje nga Njësia Përgjegjëse DMZP.

Kolegji i Këshillit, konstaton së në konkursin Nr.Reference: RN00012073 për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm pozita Inspektor i Tregut, 27 pozita, kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në fusha: Arsim i Lartë i paspecifikuar;*
- *Kualifikime të posaçme formale;*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se në këtë procedurë dy herë është shtyrë afati njëherë në fazën e verifikimit paraprak dhe herën tjetër në fazën e testit me shkrim në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe ka kundërligjshmëri për shkak se afati edhe pse është shtyrë për 30 ditë testi me shkrim është mbajtur më datë 24.10.2023 ndërsa sipas shtyrjes i bie që testi me shkrim të mbahej prej datës 11.11.2023 e tutje, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se afati për aplikim për këtë grup ka përfunduar më datë 11.08.2023, dhe në bazë të provave materiale të lëndës, konkretisht Listës së aplikantëve rezulton se në këtë procedurë pranimit kanë aplikuar gjithsej 608 kandidatë, kështu që si rezultat i numrit të madh të aplikacioneve dhe shqyrtimit të detajuar të administrativ për të gjithë kandidatët, Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë më datë 25.08.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.prot: 1320 për shtyrje të afatit për 15 ditë për përfundimin e verifikimit paraprak, ndërsa verifikimin paraprak ka përfunduar më datë 11.09.2023, kurse pas përfundimit të fazës së ankesave në këtë fazë verifikimi përfundimtar paraprak është publikuar më datë 19.09.2023. Më datë 09.10.2023 sipas Vendimit me Nr. 02/164 të Qeverisë së Republikës së Kosovës wshtw emëruar Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm, grupi Nr. 58, ndërsa ky komision më datë 10.10.2023 nxjerr Vendim me Nr. 1676/2023 për shtyrjen e afatit për 30 ditë për përfundimin e procedurës së pranimit për këtë pozitë, ndërsa e tërë procedura ka përfunduar më datë 07.11.2023. Lidhur me shtyrjen e afatit për përfundimin e procedurës e që është bërë përmes dy vendimeve të cekura si më lartë, duke marr parasysh faktin se Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht neni 98 paragrafi 1 dhe 2, përcakton se: *"1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj"*, atëherë nëse përfundimi i procedurës administrative nuk mund të bëhet brenda këtij afati për shkak të rrethanave të parashikuara me nenin 99 të këtij ligji, atëherë organi publik që shqyrton kërkesë mund të shtyja afatin për shqyrtimin e saj siç parashihet me paragrafin 1 dhe 2 të nenin 99 të këtij ligji i cili përcakton se: *"1. Përveç kur ndalohet shprehimisht me ligj, nëse është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, organi publik mund të shtyjë, vetëm një herë, afatin fillestar të paraparë për përfundimin e procedurës administrative, sipas nenit 98 të këtij Ligji. 2. Shtyrja sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme për të përfunduar procedurën administrative dhe duhet të jetë në përpjestim me kompleksitetin e çështjes konkrete, por nuk mund të jetë më e gjatë se afati fillestar"*, mbi këtë bazë Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. Prot: 1320 të datës 25.08.2023 për shtyrjen e afatit prej 15 ditësh për përfundimin e verifikimit paraprak dhe Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 1676/2023 të datës 10.10.2023 për shtyrje të afatit prej 30 ditësh për përfundimin e procedurës së rekrutimit, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të lartcekura dhe mbi bazë të kompetencave të dhëna nga

ligdhënësi dhe përfundimi i procedurës së pranimit për këtë procedurë është bërë brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e cekura si më lartë, ngase nëse llogarisim të dyja vendimet për shtyrje të afatit rezulton se afati është shtyrë për 45 ditë aq sa është edhe afatit fillestar i përfundimit të procedurës administrative. Po ashtu Kolegji i Këshillit, konstaton kur afati për përfundimin e procedurës administrative shtyhet për një periudhë të caktuar kjo nuk nënkupton që gjatë periudhës së shtyrjes nuk merren veprimet juridike, ngase sipas procedurës ligjore procedura duhet të përfundoj brenda afatit sa efekti i shtyrjes prodhon pasoja juridike, kështu që në këtë rast procedura ka përfunduar më datë 07.11.2023 brenda afateve ligjore dhe në këtë rast nuk ka pasur shkelje të të drejtave të kandidatëve në këtë procedurë, rrjedhimisht pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Nga shqyrtimi i pretendimeve ankimore që ndërlidhen me këtë pozitë, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi në bazë të provave të lëndës është përfshirë në listën e verifikimit paraprak, ndërsa është ftuar të merr pjesë në testimin me shkrim ku pas kësaj faze ka marr gjithsej 45 pikë, ndërsa pas kësaj faze është bërë vlerësimi i jetëshkrimit kur rezulton se sipas formularit të vlerësimit të jetëshkrimit ankuesi është vlerësuar me 8.4 pikë. Rrjedhimisht në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit ankuesi është vlerësuar për nivelin e arsimimit dhe përvojës së punës dhe trajnimet .

Andaj Kolegji i Këshillit, duke ju referuar nenit 22 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, konstaton se sipas paragrafit 4 është përcaktuar: *“Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet”*, si rezultat i kësaj vlerësimi i jetëshkrimit bëhet nga secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit, të cilët bëjnë vlerësimin e detajuar për secilën prej faktorëve të përcaktuara në pajtim me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni. Vlerësimi përfundimtar i jetëshkrimit për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve, siç parashihet me paragrafin 5 të këtij neni, si rrjedhojë meqë në këtë procedurë të pranimit si kualifikim arsimor është kërkuar niveli i studimeve së paku tri (3) vite të studimeve, atëherë sipas Kolegjit të Këshillit, vlerësimin tek kjo fushë përveç nivelit të kualifikimit bëhet edhe për cilësinë e arsimimit, e ku sipas diplomës së studimeve themelore rezulton se ankuesi ka pasur notën mesatare 7.03 të studimeve, kështu që nuk mund të vlerësohet me pikët maksimale në këtë fushë, sa i përket vlerësimit të përvojës së punës në këtë pikë bëhet vlerësimi i përvojës domethënëse të punës e që sipas vërtetimeve rezulton se ankuesi nga data 01.04.2011 deri më datë 25.04.2011 ka punuar në kuadër të Regjistrimit të Popullsisë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, po ashtu nga data 01-30.11.2019 ka punuar si anketues në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, sipas kontratës mbi vepër nga data 01.04.2014 deri më datë 31.07.2014 ka qenë në marrëdhënie pune në Komunën e Malishevës, pastaj nga data 02.05.2018 deri më datë 04.05.2019 ka qenë i angazhuar si praktikant në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë në kuadër të Inspektoratit Fitosanitar, sipas kontratës për kohë të caktuar nga data 15.10.2020 deri më datë 31.05.2022 si Inspektor Sanitar, kështu që duke marr parasysh përvojën e punës së ankuesit përmes dokumentacionit të dorëzuar rezulton se i njëjti plotëson kushtin e përvojës së punës por kjo përvojë punë nuk është e gjitha

domethënëse gjegjësisht nuk është tërësisht e njëjtë me pozitën e shpallur, respektivisht nuk mund të vlerësohet me pikët maksimale në këtë fushë, ndërsa sa i përket trajnimeve ankuesi ka dërguar katër certifikata të trajnimeve.

Bazuar në provat materiale të lëndës, rrjedhë se vlerësimi i jetëshkrimit për ankuesin është bërë në pajtim me dispozitat e lartcekura, mbi këtë bazë ankuesi nuk ka arritur të grumbulloj pikët e nevojshme për të ju nënshtruar intervistës me gojë, ngase sipas nenit 34 paragrafi 10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrat e Publikë, është përcaktuar se: *"10. Kandidatët të cilët nuk i fitojnë 60% të pikëve nuk ftohen në intervistën me gojë"*, dhe nenit 23 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1. Pas vlerësimit të jetëshkrimit, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën me gojë. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë në dy hapat e para të vlerësimit, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë"*, kështu që pretendimi i ankuesit se vlerësimi i jetëshkrimit nuk ka qenë real është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili ka kërkuar që Këshilli të shqyrtoj edhe kërkesat që kërkojnë për Inspektor kur me Ligjin për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut kërkohej përgatitje superiore dhe tri vite përvojë punë në profesion, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrat e Publikë respektivisht sipas nenit 85 është përcaktuar se: *"Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj"*, me çka nënkupton se themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji siç parashihet me nenin 32 paragrafi 3 të këtij ligji, ndërsa kriteret për pozitën e kategorisë profesionale dhe grupet e caktuara janë paraparë me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Vendimi për refuzim të ankesës e kam marrë vetëm nga Komisioni i pranimit ndërsa nuk kam marrë ende përgjigje nga Njësia Përgjegjëse DMZP, Kolegji i Këshillit, lidhur me parashkrimin gjegjësisht shqyrtimin e ankesave të kandidatëve kundër fazës së vlerësimit, ju ka referuar nenit 25 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"5. Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtrijë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual. 6. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Nëse rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshëm ky nen i kësaj Rregulloreje"*, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se kompetent për të shqyrtuar ankesën e ankuesit ka qenë Komisioni i Pranimit dhe mbi bazë të kësaj kompetence i njëjti ka shqyrtuar ankesën e ankuesit, në këtë rast Departamenti për Menaxhimin e Zyrat e Publikë si njësi përgjegjëse për institucioneve të administratës shtetërore, nuk është kompetent për të shqyrtuar ankesën e ankuesit në këtë fazë të procedurës ngase kompetent është për të shqyrtuar vetëm kur kandidatët parashtrijë ankesë ndaj vendimit për refuzimin e aplikacionet konkretisht mos përfshirje në listën e

shkurtër siç parashihet me nenin 15 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Bazuar si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me Nr.1976 i datës 17.11.2023 i Komisionit të Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm përmes të cilit është refuzuar ankesa e ankuesit dhe është lënë në fuqi njoftimi i datës 09.11.2023 për rezultatin përfundimtar për ankuesin, është vendim i ligjshëm dhe ky komision ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe deponitave të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimet e ankuesit ndaj kësaj procedura janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.1483/2023, më datë 16/01/2024

Avdyr BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.